# *Takimi Konsultues*

Procesi i hartimit të

Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve

për grantin e performancës

*21 Mars 2025*

*Hotel Rogner*

1

# Përse duhet të hartojmë një plan lokal për menaxhimin e mbetjeve?

***LIGJIT NR. 10463,** DATË 22.9.2011 "PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETJEVE", I NDRYSHUAR (2013, 2022)*

1

KËRKESË LIGJORE

2

***LIGJI NR. 139/2015** "PËR VETËQEVERISJEN VENDORE")*

*SYNON GJETJEN E RRUGËVE* PËR TË ZBËRTHYER NË NIVEL VENDOR KËRKESAT DHE STANDARDET KOMBËTARE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE

PËRSE NJË PLAN LOKAL PËR MBETJET?

- **Qëllimi i Planit** është të përmirësojë **cilësinë** e përgjithshme të **shërbimit**, **cilësinë e mjedisit** dhe **cilësinë e jetës për qytetarët** dhe të bëjë të mundur që Bashkia të jetë më tërheqëse për vizitorët.
- **Objektivat e planit:** përmirësimi i **performancës sasiore dhe cilësore** të shërbimit, **performancës financiare** si optimizimi i kostos së shërbimit, **performancës mjedisore** (trajtimi i mbetjeve në harmoni me mjedisin).
- **Plani hartohet** për një periudhe 5 vjeçare sipas një metodologjie të standartizuar lehtësisht të monitorueshme.

# Përse duhet të hartojmë një plan lokal për menaxhimin e mbetjeve?

**Planifikimi strategjik dhe menaxhimi më efektiv i burimeve**

Pa një plan të mirëfilltë, bashkitë përballen shpesh me sfida të menaxhimit reaktiv të mbetjeve dhe vështirësi në alokimin efektiv të burimeve financiare dhe logjistike. Një plan i strukturuar ndihmon në optimizimin e grumbullimit, transportit dhe trajtimit të mbetjeve.

**Shëndeti publik dhe shërbimi për qytetarët**

Menaxhimi i dobët i mbetjeve prek drejtpërdrejt mirëqenien e komunitetit, duke ndikuar negativisht në shëndetin publik dhe cilësinë e jetës. Plani është një instrument ***që garanton një shërbim më të sigurt***, më efikas dhe më të qëndrueshëm për qytetarët.

**Mundësitë për financime dhe projekte**

Mungesa e një plani shpesh e penalizon një bashki në aplikimet për fonde kombëtare apo ndërkombëtare. Shumë donatorë dhe programe të BE-së e kanë si kriter të domosdoshëm ekzistencën e një plani të miratuar.

**Përfshirja e sektorit privat dhe ekonomia qarkulluese**

Plani lokal mund të jetë një bazë për krijimin e partneriteteve publike-private dhe për të nxitur praktikat e ekonomisë qarkulluese, duke i dhënë vlerë mbetjeve përmes riciklimit, ripërdorimit dhe kompostimit.

**Ndërgjegjësimi dhe edukimi i komunitetit**

Pa përfshirjen dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve, asnjë plan nuk është efektiv. Plani lokal përcakton qartë edhe fushatat për ndërgjegjësim dhe edukim për ndarjen e mbetjeve dhe uljen e ndotjes.

# Elementët Kryesor të Planit të Menaxhimit të Mbetjeve

1. Përshkrimi i gjendjes ekzistuese
2. Hartimi i Objektivave SMART
3. Hartimi i Skenarëve të MIMU
4. Llogaritja e Kostos dhe Tarifave
5. Hartimi i Planit të Veprimit

1

# Mbledhja e të dhënave të nevojshme për zonën e mbetjeve

I. Informacioni i përgjithshëm për zonën e mbetjeve

II. Informacioni specifik për gjenerimin dhe menaxhimin e mbetjeve

III. Paraqitja në hartë e informacionit të përmbledhur



1

# Mbledhja e të dhënave të nevojshme për zonën e mbetjeve

## I. Infomacioni i përgjithshëm për zonën e mbetjeve



Nr. i popullsisë, nr. i familjeve, nr, i bizneseve, nr. i institucioneve



Lloji dhe kapaciteti i industrive dhe organizmave specifikë (spitalet) etj



Infrastruktura rrugore (rrugë të asfaltuara dhe jo të asfaltuara)



Tipologjia e banesave (vila, aparatmente) dhe aksesi në rrugë kryesore

1

# Mbledhja e të dhënave të nevojshme për zonën e mbetjeve

**II. Informacioni specifik për gjenerimin dhe menaxhimin e mbetjeve**

**Shërbimi i mbetjeve**

Lloji i mbetjeve sipas gjeneruesit

Karakteristikat e kontenierëve dhe mjeteve

Karakteristikat e PGM

**Shërbimi i pastrimit të rrugëve**

Shërbimet e pastrimit të rrugëve

Frekuenca e kryerjes së shërbimit gjatë muajve të vitit dhe oraret gjatë ditës.

**Personeli/stafi i punës**

Numri i personelit përgjegjës për shërbimin. Efikasiteti dhe efektiviteti në punë.

Numri i personelit përgjegjës për shërbimin e pastrimit

1

# Paraqitja në hartë e zonës së mbetjeve

- Zona e mbetjeve ku do të fillojë ose të përmirësohet shërbimi
- Kufijtë e zonës, rrugët e shërbimit për grumbullimin e mbetjeve, rrugët për t'u pastruar, pikat ekzistuese të grumbullimit të mbetjeve, iteneratet e mjeteve dhe rruga për në deponinë finale
- Përcaktimi i nën zonave (banim, komerciale, industriale)





# Prezantimi i indikatorëve të performancës

## Objektivi kryesor është matja e performancës së shërbimit

PREZANTIMI I INDIKATORËVE

PËRCAKTIMI I MËNYRËS SË LLOGARITJES

MBLEDHJA E TË DHËNAVE

PËRCAKTIMI I ASPEKTEVE TË VLERËSIMIT

PËRCAKTIMI I OBJEKTIVAVE TË QARTA



# Prezantimi i indikatorëve të performancës

## ASPEKTET KRYESORE TË VLERËSIMIT

- CILËSIA E SHËRBIMIT
- QËNDRUESHMËRIA MJEDISORE
- QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE DHE EKONOMIKE
- KOHERENCA DHE TRANSPARENCA INSTITUCIONALE

## I. INDIKATORËT SASIOR

- MBULUESHMËRIA ME SHËRBIM
- GRUMBULLIMI I DIFERENCUAR
- TRAJTIMI SIPAS LEGJISLACIONIT
- MBULIMI I KOSTOS
- GRUMBULLIMI I TARIFËS

## II. INDIKATORËT CILËSORË

- ROLI I BASHKISË ME MM
- PASTËRTIA E BASHKISË
- KËNAQËSIA E PUBLIKUT
- TRANSPARENCA E SISTEMIT

# Matja dhe prezantimin i performancës

## Vlerësimi i performancës së sistemit të MIM

| | | | Klasifikimi i koduar sipas ngjyrave | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | I ulët | Mesatarisht i ulët | I mesëm | Mesatarisht i lartë | I lartë |
| Indikatorët e cilësisë së shërbimit | C1 | Eficenca në grumbullimin e mbetjeve | 0 – 49 % | 50 – 69 % | 70 – 89% | 90 – 98% | 99 – 100% |
| | C2 | Efektiviteti i grumbullimit të mbetjeve dhe fshirjes së rrugëve | 0 – 20 % | 21 – 40 % | 41 – 60% | 61 –80% | 81 – 100% |
| | C3 | Eficenca në adresimin e ankesave të klienteve | 0 – 40 % | 41 – 50 % | 51 – 70% | 71 – 90% | 91 – 100% |
| Indikatorët e qëndrueshmërisë mjedisore | D1 | Shkalla e grumbullimit të diferencuar të mbetjeve | 0 – 5% | 6 – 10% | 11 – 20% | 21 – 30% | > 30% |
| | D2 | Shkalla e trajtimit të mbetjeve në përputhje me legjislacionin | 0 – 49% | 50 – 74% | 75 – 84% | 85 – 94% | 95 – 100% |
| | D3 | Shkalla e mbrojtjes së mjedisit në trajtimin dhe depozitimin e mbetjeve | 0 – 20 % | 21 – 40 % | 41 – 60% | 61 –80% | 81 – 100% |
| Indikatorët e qëndrueshmërisë ekonomike dhe financiare | E1 | Shkalla e rikuperimit të kostos | 0 – 40% | 41 – 60% | 61 – 75% | 75 – 85% | 85 – 100% |
| | E2 | Eficenca në mbledhjen e tarifave | 0 – 40% | 41 – 60% | 61 – 75% | 75 – 85% | 85 – 100% |
| Indikatorët e aspekteve institucionale | F1 | Vlerësimi i përshtatshmërisë së politikave kombëtare të MMN përfshirë zbatimin | 0 – 20 % | 21 – 40 % | 41 – 60% | 61 –80% | 81 – 100% |
| | F2 | Shkalla e koherencës së institucioneve lokale | 0 – 20 % | 21 – 40 % | 41 – 60% | 61 –80% | 81 – 100% |

# Matja dhe prezantimin i performancës

## Shembull - Vlerësimi i performancës së sistemit të MIM

- Procesi i planifikimit do të synojë hartimin e shërbimit me qëllim rritjen e këtyre indikatorëve të performancës dhe të reflektojë atë në kosto.
- Rritja e çdo indikatori ka një kosto.
- Objektivi për bashkinë është të vendosë objektiva të cilat janë të përballueshme për gjendjen financiare të saj.

| | Indikatorët | Shkodër | Ana Malit | Bërdicë | Guri i Zi | Postribë | Rrethinat | Dajç | Velipojë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Cilësia e shërbimit | C1 Mbulimi i zonës me shërbim | 90% | 73% | 69% | 53% | 55% | 68% | 73% | 70% |
| | C2 Pastërtia e qytetit/zonës | 82% | 32% | 49% | 32% | 32% | 32% | 49% | 49% |
| | C3 Shkalla e kënaqësisë publike | I panjohur | I panjohur | I panjohur | I panjohur | I panjohur | I panjohur | I panjohur | I panjohur |
| Qendrueshmëria mjedisore | D1 Shkalla e grumbullimit të diferencuar | 0.2% | 0% | 0% | 0% | 0% | 0% | 0% | 0% |
| | D2 Shkalla e mbetjeve të trajtuara sipas normave | 100% | 22% | 90% | 90% | 80% | 80% | 60% | 50% |
| Qendrueshmëria ekonomike dhe financiare | E1 Mbulimi i kostos | 83% | 12% | 56% | 25% | 12% | 17% | 38% | 33% |
| | E2 Shkalla e mbledhjes së tarifës | 111% | 33% | 103% | 55% | 55% | 47% | 58% | 50% |
| | E3 Transparenca në sistemin e faturimit | Mestar | I ulët | I ulët | I ulët | I ulët | I ulët | I ulët | I ulët |
| | Lek/ton | 4,733 | 20,995 | 19,047 | 10,880 | 27,677 | 26,115 | 9,975 | 11,980 |
| | Lek/banorë/vit | 1,456 | 781 | 434 | 457 | 646 | 748 | 409 | 2058 |

# Elementët Kryesor të Planit të Menaxhimit të Mbetjeve



# 2 Hartimi i objektivave të planit lokal të menaxhimit të mbetjeve



**S** Detajojnë ekzaktësisht atë që ju doni

**M** Arritja ose progresi mund të maten

**A** Janë të pranueshme nga ata që janë përgjegjës për t'i përmbushur

**R** Janë të orjentuara nga rezultatet dhe në përputhje me qëllimin

**T** Janë të përcaktuara në kohë

2

# Hartimi i objektivave të planit lokal të menaxhimit të mbetjeve

## Shembull i objektiva të një plani

- Konsolidimi i shërbimit dhe mbulimi 100% i pjesës urbane të bashkisë dhe zgjerimi i shërbimit në zonat ku aktualisht ai nuk ofrohet **në masën 40 %** gjatë periudhës 2018 – 2023

- Rritja e shkallës së grumbullimit të diferencuar tek bizneset **në masën 10%** dhe pilotimi i sistemit të grumbullimit të diferencuar me dy kosha (të riciklueshme të thata dhe të tjera) për banorët në tre zona të qytetit përgjatë periudhës 2018 – 2023

- Rritja e mbulimit të kostos operacionale **me 5% çdo vit**, gjatë periudhës 2018 – 2023

- Rritja e shkallës së grumbullimit të tarifës **në masën 100% për bizneset, 85% për banorët dhe 90% për institucionet** përgjatë periudhës 2018 - 2023

# Elementët Kryesor të Planit të Menaxhimit të Mbetjeve



# Hartimi i objektivave të planit lokal të menaxhimit të mbetjeve

## Si objektivat përkthehen në skenarë të ofrimit të shërbimit

- ✓ Të gjithë skenarët e mundshëm që do të jenë subjekt i vlerësimit duhet të shtrihen ndërmjet dy skenarëve ekstremë **“bëj minimumin”** dhe **“bëj gjithçka”**
- ✓ Skenari **“bëj minimumin”** paraqet një projeksion të asaj që ndodh aktualisht që do të ndodhë sikur të mos bëhet asnjë ndërhyrje, duke vazhduar me situatën **“biznesi si zakonisht”**
- ✓ Ky skenar është një bazë krahasimore shumë e dobishme për të krahasuar skenarët e tjerë me të, edhe pse ai, pothuajse me siguri, nuk do të përmbushë objektivat e përcaktuara
- ✓ Ndërsa skenari **“bëj gjithçka”** është një kombinim i të gjithë ndërhyrjeve të mundshme, në nivelet e tyre maksimale

# Shembuj skenarësh të një plani lokal të menaxhimit të mbetjeve

## 01 Skenari Bazë

Grumbullim i mbetjeve miks në **80%** të zonës urbane dhe **40%** zonës rurale
Transportim i tyre me mjete teknologjike të amortizuara
Depozitimi i tyre në fusha depozitimi, pranë lumenjëve apo jashtë çdo lloj kontrolli

## 02 Skenari I

Grumbullimi i mbetjeve (zona urbane **100%** dhe **80%** zona rurale)
Transportimi me mjete teknologjike dhe ndërtimi i qendrave të transferimit (qendra për rikuperimin e materialeve)
Depozitimi **60%** të sasisë së mbetjeve në venddepozitime të kontrolluara dhe **40%** në TS drejt impianteve
Identifikimi dhe eleminimi i grumbullimeve ilegale ne të gjithë teritorrin e Bashkisë

## 03 Skenari II

Grumbullimi i diferencuar me dy kosha në tre zona pilote të qytetit / grumbullim i diferencuar për bizneset
Transportimi i diferencuar i mbetjeve të riciklueshme dhe mbetjeve mix (në TS dhe qendra për rikuperimin e materialeve)
Depozitimi të gjitha mbetjeve në impiante të përpunimit dhe asgjesimit përfundimtar
Organizimi i infrastrukturës së grumbullimit të diferencuar të rrymave të tjera

# Elementët Kryesor të Planit të Menaxhimit të Mbetjeve



# Komponentët e Kostos sipas VKM 319/2018

## 01

**VALIABLA FIKSE**

Tipi i kamionit
Tipi i kontenierit
Të dhëna specifike për kontënierët dhe kamionat (koef mbushjes, kapaciteti, çmimi)
Niveli i pagave
Kosto e landfill/Incenerator

## 02

**TË DHËNAT BAZË**

Popullsia
Norma gjenerimit
Distanca në landfill
Distanca për grumbullimin e mbetjeve
Tipi i kamionit
Frekuenca e grumbullimit

## 03

**KOSTO SIPAS ZONAVE TË SHËRBIMIT**

Sasia e mbetjeve
Nr. Kontenierëve/turne
Nr. Kontenierëve
Kosto operative (grumbullim, transport, mirëmbajtje, personel)
Investimet kapitale
Kosto amortizimi
Kosto depozitimi

## 04

**KOSTO NJËSI PËR BANORË/TON MBETJE TË TRAJTUARA**

Kosto grumbullimi
Kosto transporti
Kosto mirëmbajtje
Kosto personeli
Kosto Amortizimi
Kosto depozitimi

**TË DHËNA QË MUNDËSOHEN NGA BASHKIA** (01–02)

**TË DHËNA QË LLOGARITEN NGA SISTEMI** (03–04)

| *Zona e sherbimit* | **Zona 1** |
|---|---|
| *Kostot totale të menaxhimit [LEK/vit}* | **21,778,828.49** |

# Kostot njësi

# Lek/banorë

# Lek/ton mbetje

| Kostot e menaxhimit të mbetjeve për banor | | |
|---|---|---|
| *Grumbullim* | 242 Lek | 2.31 € |
| *Transport* | 105 Lek | 1.00 € |
| *Mirëmbajtje* | 48 Lek | 0.45 € |
| *Personel* | 442 Lek | 4.20 € |
| *Amortizim* | 80 Lek | 0.76 € |
| *Depozitim* | 630 Lek | 6.00 € |
| **Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative** | **1,546 Lek** | 14.72 € |

| Kosto për menaxhimin e mbetjeve për ton në vit | | |
|---|---|---|
| *Grumbullim* | 1,107 Lek | 10.54 € |
| *Transport* | 478 Lek | 4.55 € |
| *Mirëmbajtje* | 218 Lek | 2.07 € |
| *Personel* | 2,016 Lek | 19.20 € |
| *Amortizim* | 365 Lek | 3.48 € |
| *Depozitim* | 2,875 Lek | 27.38 € |
| **Total, përfshi të ardhura neto dhe kosto administrative** | **7,058 Lek** | 67.22 € |



# Elementët Kryesor të Planit të Menaxhimit të Mbetjeve



# SI KONCEPTOHET NJË PLAN VEPRIMI?



# Komponenti: Kuadri ligjor dhe institucional

| Objektivi Strategjik | | Veprimet e detajuara | Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë | Afatet kohore |
|---|---|---|---|---|
| **Përgatitja e kuadrit ligjor dhe rregullator lokal të menaxhimit të mbetjeve në përputhje me kërkesat në nivel kombëtar** | 1.1.1 | Miratimi i Planit Lokal të Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve Ngurta Bashkiake; | Bashkia Shkodër; Këshilli Bashkiak | 2017-2018 |
| | 1.1.2 | Përditësimi i Rregullores Lokale të Manaxhimit të Mbetjeve në kushtet e ndarjes së re administrative; | Bashkia Shkodër (Përgjegjësi i Shërbimeve, Dep. Juridik) Konsultentë të jashtëm & Ekspertë; Këshilli Bashkiak | 2017-2018 |
| | 1.1.3 | Aprovimi i sanksioneve lokale dhe penaliteteve për çështjet e mbetjeve; | Bashkia Shkodër, (Përgjegjësi i Shërbimeve, Dep. Juridik, Drejtoria e manaxhimit financiar) Këshilli i Bashkiak | 2017-2018 |
| | 1.1.4 | Aplikimi i instrumentave të komunikimit dhe informimit të komunitetit rreth rregullave dhe penaliteteve; | Bashkia Shkodër, (Përgjegjësi i Shërbimeve), Vullnetarët, OJQ, përfaqësues të komunitetit, | 2018-2022 |
| **Parandalimi i ndotjes nga gjenerimi dhe depozitimi pa kriter i mbetjeve të rrezikshme (si dhe spitalore) në zbatim të legjislacionit shqiptar** | 1.2.1 | Informimi i komunitetit për të diferencuar mbetjet e rrezikshme nga mbetjet urbane si dhe detyrimet e tjera të prodhuesit të mbetjeve; | Bashkia Shkodër, (Administratorët e NJA, Përgjegjësi i Shërbimeve), Shkollat, ARM, Donatorët dhe organizatat -joqeveritare | 2018 -2022 |
| | 1.2.2 | Krijimi i skemave efektive për grumbullimin e ndarë të mbetjeve të rrezikshme (të ngjashme me skemat e redukimit të mbetjeve); | Bashkia Shkodër, (Përgjegjësi i Shërbimeve); ARM, ISHMPU, ISHSH Donatorët dhe organizatat -joqeveritare | 2018-2022 |
| | 1.2.3 | Ruajtja e sigurtë në mënyrë të përkohshme e mbetjeve të rrezikshme (sipas rregullores për administrimin e tyre) derisa të sigurohet një zgjidhje rajonale apo kombëtare për trajtimin përfundimtar të tyre. | Bashkia Shkodër, (Drejt. Shërbimeve publike) ARM, Donatorët dhe organizatat -joqeveritare | 2017-2018 |

## Komponenti: Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve dhe Pastrimi i Rrugëve

| Objektivi Strategjik | | Veprimet e detajuara | Roli drejtues dhe Partnerët e tjerë | Afatet kohore |
|---|---|---|---|---|
| **Përmirësimi i shërbimeve të mbetjeve në Bashkinë Shkodër; Ofrimi i shërbimeve efiçiente dhe cilësore;** | 2.1.1 | Riorganizimi i zonave të shërbimit të mbetjeve (ndarje e Bashkisë në tre zona shërbimi: Zona Lindore (NJA Rrethinat, NJA Postribë, NJA Shalë, NJA Pult, NJA Shosh, NJA Guri i Zi); Zona Perëndimore (NJA Velipojë, NJA Dajç, NJA Ana Malit, NJA Bërdicë), Zona Qëndrore (NJA Shkodër); | Bashkia Shkodër; (Kryetari, z. Kryetari Drejtori i shërbimeve, Përgjegjësi i shërbimit të mbetjeve) | 2017-2018 |
| | 2.1.2 | Hartimi i dokumnetave të tenderit për tre kontrata e reja, sipas tre zonave në të cilat do të ofrohet shërbimi. Hapja e tenderit, përzgjedhja e kompanive që do të ofrojnë shërbimin; | Bashkia Shkodër; (Kryetari, z. Kryetari Drejtori i shërbimeve, Përgjegjësi i shërbimit të mbetjeve, Ekspertë të jashtëm, Zyra Jurike); | 2017-2018 |
| | 2.1.3 | Shtrirja e shërbimit në NJA në të cilat nuk ofrohej shërbimi i mbetjeve (NJA Pult, NJA Shosh, NJA Shalë) dhe konsolidimi i shërbimit në NJA të cilat kanë patur shërbim. Investim në infrastrukturë duke e përmirësuar atë, në sajë të nevoja të reja që ka Bashkia e re (blerje kontenierë dhe mjete teknologjike; | Bashkia Shkodër, (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, zyra jurike dhe financave); | 2018-2019 |
| | 2.1.4 | Monitorimi i rregullt i shërbimit të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve në të tre zonat e mbetjeve (tre kontrata e shërbimit). Raportime të rregullta nga të gjithë aktorët e përfshirë në systemin e monitorimit në instancat vendimmarrëse të bashkisë. Përgatitja e raporteve ditore/javore dhe mujore të gjendjes së PGM për të gjitha NJA; | Bashkia Shkodër, (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, kompanitë private); | 2018-2022 |
| | 2.1.5 | Prezantimi i skemave të ndarjes në burim në rrugët kryesore të qytetit dhe në shkollat 9 vjeçare dhe të mesme të qytetit (mbetje të njoma dhe të thata); | Bashkia Shkodër, (Administratorët e NJA; Përgjegjësi i Shërbimeve & inspektorët bashkiakë, kompanitë private); | 2019-2022 |

# Fazat e hartimit te planit per MIM



# Instrumentat e planifikimit të hartuara deri tani










**VKM nr. 319, datë 31.05. 2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve"**